



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008 , neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400-15449 të datës 17.03.2021 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan 01-400-01-19079 e datës 13.04.2021, Kryetari i Komunës, nxjerr:

VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **5,880.00€**, (pesë mijë e tetëqind e tetëdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-47714 të datës 05.09.2022, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 28 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin gusht të vitit 2022 me nga 210 euro për secilin rast $28 \times 210 = 5,880.00€$, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI – dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan 01-400-01-19079 e datës 13.04.2021.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2022, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryeatrit të Komunës në xhironlogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB .

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërliken me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame e Kosovës dega në Lipjan.

INr.400/01-47714
Lipjan, më 05.09.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, nenit 23 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATËS TË OJQ-SË PËRFITUESE TË PROJEKTIT "PLANI I VEPRIMIT RINOR LOKAL 2022-2024"

Neni 1

Me këtë Vendim, **Bekim Zaskoku**, Zyrtar në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** Zyrtar përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratës me OJQ-në përfituese për Projektin Plani i Veprimit Rinor Lokal 2022-2024.

Zyrtari përgjegjës do të bëjë monitorimin e zbatimit të kontratës të OJQ-së si në vijim:

Nr.	Emërtimi i OJQ-së
1.	OJQ-në ARDNJ-Ë/YAHR"

Neni 2

Zyrtari përgjegjës është i obliguar të bëjë monitorimin e zbatimit të Kontratës së OJQ-së të cekura në nenin 1 të këtij Vendimi konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.


Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyrtari përgjegjës dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

1Nr. 453/01-48396
Lipjan, më 07.09.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/ L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari Komunës merr:

**VENDIM
PËR CAKTIMIN E KOORDINATORRES PËR INTEGRITET PËR KOMUNËN E
LIPJANIT**

Neni 1

Me këtë Vendim LINDA SHAHINI, në pozicionin e punës Zyrtare për Integritet Evropiane, **CAKTOHET**, Koordinatorë për Integritet për Komunën e Lipjanit .

Neni 2

Koordinatorja për Integritet është përgjegjëse për:

përgatitur metodologjinë për monitorimin e Planit të Integritetit;

- raportimin mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- të mbledhë dhe analizon dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me funksionimin e organeve të Komunës, i cili është baza për vlerësimin e rrezikut dhe zhvillimin e Planit të Integritetit;
- pranimin dhe rishikimin e informacionit për situatat, ndodhitë dhe veprimet për të cilat ekziston një besim i arsyeshëm se ato përfaqësojnë një mundësi për shfaqjen dhe zhvillimin e korrupsionit, konfliktit të interesit dhe formave tjera të sjelljeve jo etike;
- përgatitë dhe shpërndan pyetësozin si dhe zhvillon intervistat me stafin komunal, me qëllim të mbledhjes së informatave për hartimin e Planit të Integritetit;
- në bashkëpunim me të gjitha njësitë organizative, përgatit raportet për zbatimin e planit të integritetit;

- sigurimin e zbatimit, azhurnimit dhe vlerësimit në bazë të vazhdueshëm të Planit të Integritetit si dhe standardet, format dhe procedurat për të mbështetur Planit të Integritetit;
- harton raporte periodike për monitorimin e planit të integritetit dhe i raporton kryetarit.

Koordinatorja, gjithashtu, mbështet grupin punues në hartimin dhe përgatitjen e raporteve për zbatimin e Planit të Integritetit. Koordinatorja i rekomandon Kryetarit për takim me grupin punues sa herë që vlerësohet e nevojshme.

Neni 3


Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesia e grupit punues për hartimin e Planit të Integritetit dhe Koordinatorja Linda Shahini.

1Nr. 112/02-48543
Lipjan, më 08.09.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr :

VENDIM
PËR FORMIMIN E GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E DRAFT-PLANIT TË
INTEGRITETIT NË KOMUNËN E LIPJANIT 2023-2027

Neni 1
Përbërja

Formohet, grupi punues për hartimin e Draft-Planit të Integritetit në Komunën e Lipjanit 2023-2027, në përbërje si vijon:

1. Anila Reçica, Drejtoreshë e Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesuese
2. Burim Gashi, Drejtorati për Administratë, anëtar
3. Safet Krasniqi, Zyra e Auditorit të brendshëm ,anëtar
4. Merita Zeqiri, Drejtorati për Infrastrukturë, anëtare
5. Kushtrim Salihu, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtar
6. Islam Kaleshi , Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtar
7. Albert Mustafa, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtar
8. Floranda Zeqiri, Drejtorati për Arsim, anëtare
9. Shehadije Ibrahim, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
10. Shqipe Rexhepi, Drejtorati për Inspeksion, anëtare
11. Shehide Sopa, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtare
12. Rafete Retkoceri, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtare
13. Xhevahire Zeqiri, Sektori per personel, anëtare
14. Bekim Arifi, Drejtorati për Prokurim, anëtar
15. Armend Duriqi, Drejtorati për Inspektorat, anëtar
16. Lorik Berbatovci, Qendra për punë Sociale, anëtar

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e grupit punues

1. Grupi punues ka për detyrë që në pajtim me dispozitat ligjore përkatëse të hartojë Draft-Planin e Integritetit për Komunën e Lipjanit 2023-2027 më së largu me datë 20.10.2022.
2. Pas hartimit të Draft- Planit, grupi punues është i obliguar t'ia dërgojë Kryetarit të Komunës për aprovim paraprak e pastaj drafti do të vëhet në diskutim publik. Organizimin e diskutimit publik do ta bëjë i njëjti grup punues në bashkëpunim me Sektorin për Informim dhe pas mbylljes së fazës së konsultimit publik - Plani nëpërmjet Zyrës së Kryetarit të Komunës do të procedohet për miratim në Kuvendin e Komunës .
3. Plani duhet të miratohet në Kuvend më së largu në seancën e muajit dhjetor 2022 pasi zbatimi i tij do të fillojë prej datës 01.01.2023.
4. Punët administrative – teknike për grupin punues do t'i kryej Drejtorati për Administratë.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohet, Kryesuesi dhe anëtarët e grupit punues si dh Koordinatori për Integritet.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi 1Nr.030/06-42953 për formimin e grupit punues për hartimin e Draft-Planit të Integritetit në Komunën e Lipjanit 2023-2025 i datës 11.08.2022 .

1Nr. 020/01-48546
Lipjan, më 08.09.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E PROJEKT- RREGULLORES SË RE
PËR SHËRBIMET PUBLIKE DHE RENDIN KOMUNAL

Neni 1
Përbërja

Formohet Komisioni për hartimin e Projektit të Rregullores së re për Shërbimet Publike dhe Rendin komunal, në përbërje si vijon:

1. Rafete Retkoceri, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Kryesuese
2. Vlora Krasniqi, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtare
3. Avni Sahiti, Drejtorati për Inspeksion, anëtar

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni ka për detyrë që të hartojë Projektin e Rregullores së re për Shërbimet Publike dhe Rendin Komunal, konform dispozitave ligjore në fuqi.
2. Komisioni i cekur Projektin e Rregullores për Transparencë duhet ta hartojë më së largu me datë 05.10.2022.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohen Kryesuesia dhe anëtarët e Komisionit .

1Nr. 020/04-49096
Lipjan, më 12.09.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, si dhe neneve 4 dhe 8 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e dates 28.06.2019, Kryetari i Komunës duke vendosur sipas kërkesës së OJQ-së OMPAKL nxjerr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

Neni 1

Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 200 € (dyqind euro), sipas kërkesës së Organizatës Multietnike të Personave me aftësi të kufizuara - OMPAKL me Nr.1-400/01-49238 të datës 13.09.2022.

Mjetet e cekura në paragrafin paraprak i ndahen për ta mbështetur financiarisht OMPAKL, me rastin e muajit tetor, muaji i mundësive të barabarta cili tashmë është bërë tradicional ku do të punësohen për periode dy ditore 10 persona me aftësi të kufizuara nga kjo OJQ, në kuadër të objekteve të administratës komunale, që do të paguhet me nga 10 euro në ditë, gjithsej 200 Euro për dy ditë sipas listës së propozuar nga OMPAKL.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2022, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirrollogarinë bankare nr. nr. 1907946619031150 në BKT.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara OJQ "OMPAKL" duhet të sjellë regjistrin me nënshkrimet e personave të cilët janë përzgjedhur të punësohen në kuadër të këtij Projekti tradicional .

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet OJQ – OMPAKL, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtorati për Administratë dhe Njësi për të drejtat e njeriut barazi gjinore në Lipjan.

1Nr.400/01-49238

Lipjan, më 19.09.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 19 të Rregullores nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR INVENTARIZIMIN E PASURISË JOFINANCIARE TË
KOMUNËS

I. Për inventarizimin e pasurive jofinanciare të Komunës formoj Komisionin në këtë përbërje:

1. Burim Gashi, Kryesues
2. Gafurr Hetemi, anëtar
3. Ramiz Gashi, anëtar
4. Ismet Haziri, anëtar
5. Behar Aliu, anëtar

II. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni në pajtim me Rregulloren nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore, ka për detyrë dhe përgjegjësi si vijon :

1. Të inventarizoj të gjithë pasurinë jofinanciare që është në pronësi dhe kontroll të Komunës,
2. Të bëj verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes të pasurisë jofinanciare ,
3. Të bëj krahasimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jofinanciare,
4. Të identifikojë pasurinë që nuk ka vlerë të bartur,
5. Të identifikojë pasuritë e dëmtuara dhe jashtë përdorimit

III. Përgatitja e raportit për kryerjen e inventarizimit

Komisioni pas kryerjes së inventarizimit duhet të hartoj dhe prezentoj raportin për inventarizimin e pasurisë jofinanciare më së largu deri me datë 15 Janar 2023.

IV. Me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

V. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës .

1Nr. 020/04-50267
Lipjan, më 20.09.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit Nr.06/ L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2 e datës 15 shkurt 2018 dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

Neni 1
Përbërja

Formohet, Komisioni për caktimin - dhënien e rekomandimit për normat tatimore të pronës së paluajtshme në Komunën e Lipjanit për vitin 2023, në përbërje si vijon:

1. Shahadije Ibrahim, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Kryesuese
2. Shemsi Azemi, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Sektori i tatimit në pronë, anëtar
3. Besmir Retkoceri, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Sektori i tatimit në pronë, anëtar

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Detyrë e Komisionit është që duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/ L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2 e datës 15 shkurt 2018 dhe akteve tjera nënligjore përkatëse të rishikojë paraprakisht normat tatimore aktuale dhe të japë rekomandimet nëse është e arsyeshme të ndryshohen normat tatimore për vitin tatimor 2023 të cilat planifikohet të miratohen konform dispozitave të Ligjit në muajin nëntor të vitit 2022.

Detyrat e cekura Komisioni duhet ti kryej më së largu deri me datën 22.10.2022 dhe me të njëjtin rekomandim ta njoftoj Kryetarin e Komunës.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit .

1Nr. 020/04-50275
Lipjan, më 20.09.2022



KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, si dhe neneve 4 dhe 8 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e dates 28.06.2019, Kryetari i Komunës duke vendosur sipas kërkesës së OJQ-së HANDIKOS dega në Lipjan nxjerr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

Neni 1

Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 200 € (dyqind euro), sipas kërkesës së Shoqatës së HANDIKOS dega në Lipjan me Nr.1-400/04-50082 të datës 19.09.2022.

Mjetet e cekura në paragrafin paraprak i ndahen për ta mbështetur financiarisht Shoqatën HANDIKOS, me rastin e muajit tetor, muaji i mundësive të barabarta i cili tashmë është bërë tradicional ku do të punësohen për periudë dy ditore 10 persona me aftësi të kufizuara nga kjo Shoqatë, në kuadër të objekteve të administratës komunale, që do të paguhen me nga 10 euro në ditë, gjithsej 200 Euro për dy ditë sipas listës së propozuar nga HANDIKOS.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2022, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhironlogarinë bankare Shoqatës së HANDIKOS dega në Lipjan, në nr. 1907960372031135 në BKT bankë.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara OJQ "HANDIKOS" duhet të sjellë regjistrin me nënshkrimet e personave të cilët janë përzgjedhur të punësohen në kuadër të këtij Projekti tradicional .

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet OJQ – HANDIKOS, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtorati për Administratë dhe Njësi për të drejtat e njeriut barazi gjinore në Lipjan.

1Nr.400/04-50082
Lipjan, më 20.09.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores MF - Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, duke u bazuar në kërkesën e DKA –së 1Nr.404/01-52000 të datës 26.09.2022, Kryetari i Komunës merr :

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E ÇMIMIT FILLESTAR PËR
SHTIJE E LIBRAVE JASHTË PËRDORMIT

Neni 1
Përbërja e Komisionit

Formohet, Komisioni për vlerësimin dhe përcaktimin e çmimit fillestar për shitjen e librave që janë jashtë përdorimit në IEA bazuar në kërkesën e DKA-së 1Nr.404/01-52000 të datës 26.09.2022, në përbërje si vijon:

1. Ismet Haziri, Drejtorati për Arsim, Kryesues,
2. Minavere Rexha, Drejtorati për Arsim, anëtare
3. Floranda Zeqiri, Drejtorati për Arsim, anëtare

Neni 2
Detyrat e Komisionit

Detyrë e Komisionit është që të përcaktojë çmimin fillestar për shitjen e librave të cekura në nenin 1 të këtij Vendimi dhe t'i rekomandoj Kryetarit të Komunës çmimin fillestar për shtije.

Neni 3
Hyrja në fuqi


Vendimi hyn në fuqi menjëherë ndërsa me kopjen e këtij Vendimi do të njoftohen Drejtorati për Arsim, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr.404/01-52000
Lipjan, më 26.09.2022.


KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr :

VENDIM

PËR FORMIMIN E GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E DRAFT-PLANIT PËR VLERËSIMIN E RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

Përbërja

Formohet, grupi punues për hartimin e Draft-Planit për për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Haqif Rustemi, Kryesues
2. Hasan Hajdini, anëtar
3. Gafurr Hetemi, anëtar
4. Albert Mustafa, anëtar
5. Bekim Zaskoku, anëtar
6. Rafete Retkoceri, anëtare
7. Jalldyze Gashi, anëtare
8. Afrim Sadiku, anëtar
9. Behar Mjeku, anëtar
10. Enver Elshani, anëtar
11. Brahim Duriqi, anëtar

Në rast nevojë gjatë fazës së hartimit mund të angazhohen edhe ekspert të jashtëm të cilët do ta plotësojnë grupin punues të cilët do të përzgjidhen përmes një procedure të thjeshtë të konkurimit.

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e grupit punues

1. Grupi punues ka për detyrë që në pajtim me dispozitat ligjore përkatëse të hartojë Draft- Planit për për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Lipjanit më së largu me datë 05.11.2022.

2. Pas hartimit të Draft- Planit, grupi punues është i obliguar t'ia dërgojë Kryetarit të Komunës për aprovim draftin final.
3. Punët administrative – teknike për grupin punues do t'i kryej Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohet, Kryesuesi dhe anëtarët e grupit punues.

1Nr. 020/04-52669
Lipjan, më 29.09.2022





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
SKUPŠTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të neneve 13, 17 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, dhe në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Komunës 15Nr.350/05-21269 të datës 26.04.2022 për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2023 -2031, Kryetari i Komunës merr:

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR THEMELIMIN E GRUPIT
PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL

Neni 1

Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet nenin I i Vendimit për themelimin e grupit punues për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 1Nr.020/04-31814 i datës 20.06.2022 përkatësisht të përfaqësuesit nga Drejtoratet Komunale shtohen edhe dy anëtarë të cilët do të renditen pas numrit rendor 8 (tetë), ashtu që numri i anëtarëve të grupit punues nga përfaqësuesit e Drejtorateve Komunale do të jetë 10 (dhjetë) dhe pas plotësimit neni I, riformulohet si vijon:

Përfaqësuesit nga Drejtoratet komunale:

1.	Imri Semetishti	Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
2.	Rasim Hasani	Drejtorati për Arsim
3.	Anila Reqica	Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport
4.	Shkelzen Hajdini	Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
5.	Sead Aliu	Drejtorati për Infrastrukturë
6.	Rexhep Rexhepi	Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari
7.	Valon Pacolli	Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim
8.	Vlora Krasniqi	Zyra e Kryetarit – Sektori për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore,
9.	Gjyste Dabaj	NJDNJ dhe barazi gjinore
10.	Bukurie Zejnullahu	Sektori për Marëdhënie me Publikun

Neni 2

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtori i Drejtoratit të DPUMM si kryesues i grupit dhe dy anëtarët e reja të renditura në numrin rendor 9 dhe 10.

1Nr-020/04-31814/2
Lipjan, më 29.09.2022





Pranuar me: Primljeno: 29.09.2022		
Njësia Jednic.a	Numri Broj	Shtojca Dodatak
1-352/01	-52631	

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr :

**VENDIM
PËR THEMELIMIN E EKIPIT TEKNIK**

**Neni 1
Përbërja**

Formohet, **Ekipi teknik** për vazhdimin e procesit për krijimin e bazës për zbatimin e sistemit regional të Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave në Regjionin e Prishtinës, në përbërje si vijon:

1. Labinot Dedushi, Drejtorati për Infrastrukturë, Kryesues
2. Merita Zeqiri-Magashi, Drejtorati për Infrastrukturë, anëtare
3. Islam Kaleshi, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtar
4. Shehadije Ibrahim, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
5. Bekim Arifi, Drejtorati për Prokurim, anëtar

**Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e grupit punues**


Ekipi teknik me mbështetjen dhe në koordinim me GIZ –in gjerman do të punojë në vazhdimin e procesit për krijimin e bazës për zbatimin e sistemit regional të Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave në Regjionin e Prishtinës ndërsa për punën e tij do ti raportojë Kryetarit të Komunës si dhe Ekipit drejtues i cili do të themelohet për qëllimin e njëjtë.

**Neni 3
Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e ekipit punues.

1Nr. 352/01-52631
Lipjan, më 29.09.22





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës, nxjerr:

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË LIPJAN

Neni 1

Me këtë Vendim, THEMELOHET, Këshilli Komunal për Personat me Aftësi të Kufizuara në Lipjan, në këtë përbërje:

- 1.Gjyste Dabaj , Kryesuese e Këshillit
- 2.Hasan Luma , Zëvendëskryesues i këshillit
3. Albert Mustafa, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtar
- 4.Arjeta Thaqi Stublla, Shtëpia e komunitetit për persona me aftësi të kufizuara mendore –ngecje në zhvillim mendor, anëtare
- 5.Afrim Mena OJQ- Handikos, anëtar
- 6.Fahrije LLugiqi, OJQ-OMPAKL, anëtar
- 7.Brahim Duriqi, Drejtorati për Arsim, anëtar
- 8.Selman Jashanica,Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
- 9.Lidija Jovanoviq, Zyra Lokale për Komunitete, anëtare
- 10.Behar Amrllahu, Qendra për Punë Sociale, anëtar
- 11.Laureta Ahmeti, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare

Neni 2

Këshilli Komunal për Personat me Aftësi të Kufizuara ka për qëllim që të angazhohet për krijimin e mundësive të barabarta, përmirësimin e kushteve të jetës për personat me aftësi të kufizuara në fushën e arsimit, punësimit, shërbimet ndihmëse dhe jetesës pa pengesa, parandalimin e diskriminimit ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe procesit të krijimit të politikave të gjithanshme dhe gjithëpërfshirëse, duke përditësuar kulturën e respektimit dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të personave me aftësi të kufizuara, dhe të sigurojë që nevojat dhe interesat e personave me aftësi të kufizuara të merren gjithmonë parasysh dhe me prioritet, çdo herë kur Komuna e Lipjanit merr vendim për çështjet që mund të kenë ndikim në gjendjen e personave me aftësi të kufizuara.

Takimet e Këshillit i udhëheq Kryesuesia e Këshillit Komunal për Personat me Aftësi të Kufizuara e cekur në numrin rendor 1 e në rast të mungesës së saj do të udhëhiqen nga zëvendësuesi i kryesueses i cekur në numrin rendor 2.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Drejtorati për Administratë-Njësiti për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

1Nr. 020/04-52794
Lipjan, më 30.09.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

